

NJESIA E PROKURIMIT

Maliq më: 15/02/2024

PROCES-VERBAL

-Për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kritereve për kualifikim (Ky proces-verbal është për efekt publikim bashkë me dokumentat e tenderit).

Objekti i Kontratës:

" Furnizim me depozitim materialesh konsumi për trajtimin e ujërave të ndotura për Impiantin RO"

- **2,150,000** (dy milion e njëqind e pesëdhjetë mijë) **lekë pa TVSH .**
- **2,580,000** (dy milion e pesëqind e tetëdhjetë mijë) **lekë me TVSH .**

Në bazë të nenit 21 pika 2 e ligjit nr 162 datë 23.12.2020 " Për Prokurimin Publik" , nenit 2 pika 2 gërma (c) dhe nenit 78 pika 2 të VKM- së nr 285 datë 19.05.2021 "Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik", Autoriteti Kontraktor Administrimi i Mbetjeve Qarku Korçë ka hartuar proces-verbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kritereve për kualifikim për proçedurën e sipërcituar , me përmbajtjen si më poshtë:

2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

- a. *Formularin e Ofertës, sipas Shtojcës 1*
- b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;*
- c) *Deklaratë mbi përmbushjen e specifikimeve teknike, sipas Shtojcës 5*
- d) *Formularin e përmbushjes se kritereve sipas Shtojcës 7.*
- e) *Formularin e Vetedeklarimit sipas shtojces 8.*
- f) *Vërtetimin që konfirmon shlyerjen e të gjitha detyrimeve të maturuara të energjisë elektrike të kontratave të energjisë që ka operatori ekonomik që është i regjistruar në Shqipëri.*

2. Për të provuar përmbushjen e kapaciteteve të mëposhtme, Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.1.Kapaciteti ligjor/profesional i operatorëve ekonomikë:

Sipas Kriereve të përgjithshme dhe të vecanta të kualifikimit (Shtojcat)

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të LPP, si edhe në nenin 40 të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar.

2.2.Për kapacitetin ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Vërtetim nga administrata tatimore për xhiron e realizuar në 3 (tre) vitet e fundit 2020, 2021 dhe 2022 nga shoqëria, ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar, duhet të jetë jo më e vogël se vlera e përlllogaritur e kontratës që po prokurohet.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3 e LPP, si dhe nenin 43 pika 1, pika 2/b dhe pika 3 të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar. Ky kriter është vendosur bazuar në nenin 43 të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar “Kërkesat për kapacitetet ekonomiko-financiare”, pika 1 citon: Autoriteti/enti kontraktor, për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, kërkon kopje të deklaratave të xhiros vjetore të realizuar nga operatori ekonomik dhe, sipas rastit të xhiros që mbulon kontrata, për një periudhë maksimumi deri në 3 (tre) vitet e fundit financiare, ndërsa në pikën 2/b citohet: vlerën e përlllogaritur të kontratës ose lotit, në procedurat e prokurimit ndërmjet kufirit të lartë dhe të ulët monetar, ndërsa në pikën 3 citohet: Kërkesa për plotësimin e kapaciteteve financiare konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga autoriteti/enti kontraktor.

2.2.2 Kopje të vërtetuar të bilancit për vitet 2021,2022 , të paraqitur dhe konfirmuar pranë autoriteteve përkatëse me nënshkrim dhe vulë si dhe të shoqëruara me Akt Ekspertizën e Ekspertit Kontabël të Autorizuar në përputhje me ligjin nr. 10091 , datë 05.03.2009 " Për auditimin ligjor , organizimin e profesionit të ekspertit kontabël të regjistruar dhe të kontabilistit të miratuar" , i ndryshuar , Kreu V , neni 41 , pika c : shoqërite me përgjegjësi të kufizuar , të cilat zbatojnë për raportimin financiar standartet kombëtare të kontabilitetit , kur në mbullje të periudhës kontabël për dy vite rradhazi tejkalojnë dy prej treguesve të mëposhtem:

- i) totali i aktiveve të bilancit në mbyllje të periudhës kontabël përkatëse arrijn ose e kalon shumë prej 50 milionë lekësh,
- ii) shuma e të ardhurave nga veprimtaria ekonomike (qarkullimi) në atë periudhë kontabël arrijn ose e kalon shumë prej 100 milionë lekësh,
- iii) ka mesatarisht 30 të punësuar gjatë periudhës kontabël .

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenit 43, pika 4, të VKM nr 285 datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik". Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht është bërë bazuar në nenin 29, pika 1 e Ligjit nr 8438 date 28.12.1998 "Per Tatimin mbi të Ardhurat", i ndryshuar, si dhe kërkesave të Ligjit nr 25 të vitit 2018" Për konntabilitetin dhe pasqyrat financiare".

Kjo kërkesë përmbushet nëpërmjet plotësimit dhe paraqitjes nga operatorët ekonomikë të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8 të DST. Shenim: Në lidhje me momentin e paraqitjes së dokumentacionit dëshmuës për kërkesat që përfshihen në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, dokumentat e kërkuara më sipër do të paraqitën në rastin kur OE shpallet fitues, ose nëse kërkohen sqarime nga autoriteti kontraktor, referuar pikës 1, të nenit 26, të VKM nr.285, datë 19.05.2021, i ndryshuar, ku parashikohet: "Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoriteti/enti kontraktor pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP-së, dhe në këto rregulla", si edhe përcaktimet e pikës 6, të këtij neni, ku parashikohet: "Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat "a", "b", "d", "dh", "e", "h", "i", "j" të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin"

2.3Për kapacitetin teknik:

2.3.1 Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizimet e mëparshme të ngjashme të realizuara gjatë 3 (tre) viteve te fundit, minimalisht, ne vleren prej 40 % të vlerës së fondit limit. Këto furnizime të ngjashme duhet të vërtetohen me dokumentacionin si më poshtë:

a- Kur furnizimet e ngjashmë janë realizuar me institucione shtetërore, Operatori ekonomik do ta vërtetoje duke paraqitur Kontratën e nënshkruar me institucionin, të shoqëruar detyrimisht me vërtetimin e lëshuar nga Institucioni shtetëror për realizimin e sukseshëm të kësaj kontrate;

ose

b- Kur furnizimet e ngjashmë janë realizuar me subjekte private Operatori ekonomik do ta vërtetoje duke paraqitur faturat tatimore te shitjes ku shënohen mallrat, shumat dhe vlerat.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të Ligjit nr.162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik" dhe nenit 40, pika 4 të VKM nr.285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik" i ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë ne vlerën jo më pak se 40% e vlerës

së përlogaritur të kontratës që po prokurohet, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar. Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë: Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 40% të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar. Vlera e kërkuar është vendosur që t'i shërbejë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kapacitetet e nevojshme si dhe përvojën e duhur, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Përvoja e mëparshme është element shumë i nevojshëm që garantojnë autoritetin, se operatorët ekonomikë mbi bazën e vlerës së furnizimeve të ngjashme zotërojnë kapacitete për të zbatuar kontratën me sukses sipas një standarti të përshtatshëm cilësie.

2.3.2 Operatori Ekonomik duhet të disponoje certifikatën ISO 9001:2015 mbi “Sistemet e menaxhimit të cilësive”, leshuar nga institucionet zyrtare të akredituar për këtë qëllim. Certifikata kërkohet të jetë e vlefshme në kohën e zhvillimit të tenderit. (Në rastet e bashkimit të operatoreve ekonomik, secili operator ekonomik duhet të dorëzojë certifikatën ISO sipas zërave që ka marrë përsipër në kontratën e bashkëpunimit.).

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 44, pika 1, të VKM nr 285 datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik". ISO 9001:2015 përqendrohet në identifikimin e risqeve dhe mundësive në menaxhimin e cilësive, mirëmbajtjen e pajisjeve dhe infrastruktures për objektin e prokurimit të sipërcituar.

2.3.3 Operatori Ekonomik duhet të disponoje certifikatën ISO 14001:2015 mbi “Sistemet e menaxhimit të ambientit” leshuar nga institucionet zyrtare të akredituar për këtë qëllim. Certifikata kërkohet të jetë e vlefshme në kohën e zhvillimit të tenderit. (Në rastet e bashkimit të operatoreve ekonomik, secili operator ekonomik duhet të dorëzojë certifikatën ISO sipas zërave që ka marrë përsipër në kontratën e bashkëpunimit.).

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 44, pika 1, të VKM nr 285 datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik". ISO 14001:2015 përqendrohet tek aspektet domethënëse në mjedis, kontrollin e ndotjes ambientale dhe ka për qëllim eliminimin ose zvogelimin e efekteve negative mbi mjedisin të lidhura me aktivitetet e shoqërisë.

2.3.4 Operatorët ekonomike pjesëmarrës duhet të kenë në stafin e tyre të paktën 1 (një) kimist dhe një drejtues mjete.

- Për punonjësën “Kimist” operatori ekonomik duhet të paraqesë diplomë, dhe kontratë pune (e vlefshme për të paktën periudhën e parashikuar) si dhe të figurojë në listpagesat e shoqërisë.
- Për punonjësën “Drejtues mjeti” dokumentat që duhet të paraqes janë: Leje drejtimi për mjete që kryejn transportin e lëndëve të rrezikshme (ADR) (e vlefshme) si dhe të figurojë në listpagesat e shoqërisë.

Në rastet kur mjeti është me qera për punonjësit e mësipërm duhet të paraqitet:

Deklaratë nga operatori ekonomik që në rastin e shpalljes fituese, do të paraqesë kontratë pune me drejtuesin e mjetit { i cili duhet të ketë kontratë pune dhe leje drejtimi për mjete që kryejnë transportin e lëndëve të rrezikshme (ADR) (E VLEFSHME)}.

Shoqërite mund të paraqesin dëshmi ose dokumentacion për bashkëpunimin me kompani transportuese me të cilat bashkëpunojnë për furnizimin dhe transportimin e mallrave.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 4 e ligjit nr 162 të 2020 "Për Prokurimin Publik".

Kriteri i mesipërm është i lidhur me aftësinë dhe garancinë e burimeve të nevojshme njëzore dhe përvijën që zoterojnë ose duhet të zoterojnë operatorët ekonomikë për të zbatuar kontratën sipas një standarti të përshtatshëm cilësor. Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë në lidhje me aftësitë organizative, besueshmërinë dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën sipas nenit 77 pika 4 e ligjit nr 162 të 2020 "Për Prokurimin Publik".

2.3.5. Operatori ekonomik duhet të ketë në pronësi ose me qera 1 mjet të autorizuar për transport kimikatesh për transportin e lëndëve të rrezikshme sipas standartit të BE.

Për të vërtetuar disponimin e mjeteve të kërkuara më lart operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumentacionin e mëposhtëm:

a) *Për mjetet që shënohen në regjistra publikë duhet të paraqitet dokumenti që verteton regjistrimin e mjetit (leje qarkullimi) për “Transport lende të rrezikshme”, lejen e qarkullimit, plus certifikatën e kontrollit teknik dhe siguracionin e mjetit (te vlefshme) dhe për mjetet e siguruar me qera, dokumenti që verteton regjistrimin e tij plus certifikatën e kontrollit teknik dhe siguracionin e mjetit, (te vlefshme), duhet të shoqërohet me kontratën përkatëse të qerës/furnizimit, e vlefshme për të gjithë periudhën e realizimit të kontratës objekt i këtij prokurimi. Në rastin e mjeteve të tjera duhet të jenë aktet e çdoganimit ose faturat tatimore të blerjes.*

b) *Për mjetet që nuk shënohen në regjistra publike duhet të paraqiten dokumentat që vërtetojnë pronësinë e tyre.*

c) *Për mjetet e marra me qera të paraqitet kontrata përkatëse e qirasë ku të specifikohet objekti i kontratës dhe afati i saj.*

d) *Operatori ekonomik duhet të paraqesë foto për mjetet e deklaruar ku të jenë të dukshme dhe targat e mjetit.*

e) *Autoriteti Kontraktor rezervon të drejtën të verifikojë dhe kontrollojë në çdo kohë deri në përfundimin e kontratës mjetet dhe pajisjet teknike të deklaruara.*

Shoqërite mund të paraqesin dokumentacionin përkates të bashkepunimit me kompani transportuese (të pajisur me ADR të vlefshme) për furnizimin dhe transportimin e mallit.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është bazuar në nenin 77 pika 4 , e LPP , si dhe nenin 40 , pika 8 të VKM nr 285 datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik".

2.3.6. Furnizimi me materialet e Konsumit për trajtimin e ujërave të ndotura do të bëhet nga Operatori Ekonomik në Magazinën e Vend Depozitimit Sanitar të Mbetjeve Maliq.
Për Acidin Sulfurik furnizimi do të bëhet në depozitën e posaçme pranë Impiantit RO që ndodhet në Vend Depozitimin Sanitar të Mbetjeve Maliq.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 4 e ligjit nr 162 te 2020 "Për Prokurimin Publik".

Ky kriter përcakton aftesine teknike dhe profesionale qe zoterojne ose duhet te zoterojne operatoret ekonomike ne lidhje me burimet teknike per te zbatuar kontraten sipas nje standarti te pershtatshem cilesie, sipas nenit 77 pika 4 e ligjit nr 162 te 2020 "Për Prokurimin Publik".
Ky kriter është i nevojshëm për Autoritetin Kontraktor pasi kemi të bëjmë me një lëndë të rrezikshme siç është acidi sulfurik për të cilin kërkohet mjet i posaçëm që të bëjë furnizimin në depozitën depozitën pranë Impiantit RO që ndodhet në Vend Depozitimin Sanitar të Mbetjeve Maliq.

Të gjithë dokumentat duhet të jenë origjinalë ose kopje të noterizuara të tyre. Rastet e mos-dorëzimit të një dokumenti, ose të dokumentave të rreme e të pasakta, konsiderohen si kushte për skualifikim.

SPECIFIKIMET TEKNIKE

Specifikimi i Materialeve, Skicimet, parametrat teknik etj:

Përshkrimi i të dhënave teknike të mallrave objekt prokurimi të përshkruara sa më saktë dhe në mënyrë të plotë, duke krijuar kushte për konkurrim të paanshëm e të hapur ndërmjet të gjithë kandidatëve e ofertuesve.

Përshkrimi i kërkesave të zbatimit të shërbimeve në lidhje me to:

Nr	Pershkrimi	Njësia	Sasia
1	Solucion me pH të ulët MCT113	Kg	500
2	Acid citric (C₆H₈O₇) monohidrat	Kg	250
3	Solucion me pH të lartë MCT515	Kg	200
4	Acid sulfurik (H₂SO₄) cc 97.5-98.5%	Kg	26 000
5	Antiskalant NSF/ANSI Standart 60	Kg	500
6	Hipoklorit natriumi(Cl₂13-15%)	Kg	200
7	Ujë i distiluar	Litra	20
8	Acid Klorhidrik (HCl)	Kg	100
9	Bufera për kalibrim Ph4 Ph7	Litra	4

Tabelat dhe specifikimet e detajuara

1-Për furnizimin me solucione pastrimi me Ph të ulët tek tabela nr.1 po japim specifikimet dhe të dhënat për sasi të e nevojshme:

Tabela 1

Solucion me pH të ulët MCT113	
pH	3.0 ± 0.5
I projektuar posaçërisht për të hequr hidroksidet e metaleve Fe, Al, Mn, karbonat kalciumi dhe fosfat kalciumi shkallë të tjera të ngjashme nga osmoza e kundërt (RO), nanofiltrimi (NF) dhe ultrafiltrimi (UF)	Të përdoret në tretësirën 2%
SASIA	500 kg

2-Për Acid citric (C₆H₈O₇) monohidrat tek tabela nr.2 po japim specifikimet dhe të dhënat për sasi të e nevojshme:

Tabela 2

Acid citrik (C₆H₈O₇) monohidrat	Njësia	Specifikime
Përmbajtja	%	99.9-100.5
Pamja	-	Pa ngjyrë ose e bardhë, granulare ose pudër
Uji	%	Uji % 7.5-9
Oksalate	ppm	360
Sulphated ash	%	0.10
Sulfate	ppm	150
Alumin	ppm	0.2
Sasia	kg	250

3-Për furnizimin me solucione pastrimi me Ph të lartë tek tabela Nr.3 po japim specifikimet dhe të dhënat për sasi të e nevojshme:

Tabela 3

Solucion me pH të lartë MCT515	
pH	12.0 ± 0.5
Për përdorim në heqjen e fulateve organike sic janë vajrat dhe bioproteinat nga elementët e membranës	
SASIA	200 kg

4- Për furnizimet me acid sulfurik (H₂SO₄) tek tabela Nr 5 po japim specifikimet dhe të dhënat për sasi të e nevojshme:

Tabela nr.4

H₂SO₄	Lëng pa ngjyrë	% Përqëndrim	97.5- 98.5
Densiteti në 20° C		kg/lt	1.845-1.850
Dioksid sulfuri	SO₂	mg/kg	<5
Hekur	Fe	mg/kg	<15
Zink	Zn	mg/kg	<0.25
Plumb	Pb	mg/kg	< 0.03
Arsenik	As	mg/kg	<0.03
Bakër	Cu	mg/kg	<0.02
Mërkur	Hg	mg/kg	<0.01
Sasia			26 000 Kg

5-Për furnizimin me antiskalant që duhet të aplikohet për ujëra deti dhe ujëra të ndotura me çertifikate NSF/ANSI Standart 60 tek Tabela 4 po japim specifikimet teknike dhe sasinë e kërkuar:
Tabela 5

ANTISKALANT	Lëng pa ngjyrë
Densiteti në 20° C	1.15-1.25 kg/lt
pH(10% solucion)	5-7
Dozimi	2-5 mg/l
Të ketë fuqi ndërvepruese për:	
Calcium Carbonate	CaCO₃
Calcium Sulfate	CaSO₄
Barium Sulfate	BaSO₄
Strontium Sulfate	SrSO₄
Calcium Fluoride	CaF₂
Silica	SiO₂
Sasia	500 kg

- Për Furnizim me hipoklorit natriumi që përdoret për larje dhe dizifektime, tek tabela Nr 6 po japim specifikimet dhe të dhënat për sasinë e nevojshme:

Tabela Nr.6

Nr.	Parametrat	Njësia e matjes	Specifikat
1	Gjendja	-	Lëng i qartë
2	Ngjyra	-	E verdhë
3	Densiteti 20°C	gr / ml	1.13-1.24
4	Titulli Cl₂	% (m/m)	13-15
5	Substancat toksike	mg / kg	Limitet në mg / kg të klorit të lirë
6	Arsenik (As)	mg / kg	max 1
7	Kadmium (Cd)	mg / kg	max 2.5
8	Krom (Cr)	mg / kg	max 2.5
9	Mërkur (Hg)	mg / kg	max 3.5
10	Nikel (Ni)	mg / kg	max 2.5
11	Plumb (Pb)	mg / kg	max 15
12	Antimon (Sb)	mg / kg	max 20
13	Selen (Se)	mg / kg	max 20
	Sasia		200 Kg

7- Furnizimi me uje të distiluar (H₂O) sipas GOST 6709-72 tek tabela Nr 7 po japim specifikimet dhe të dhenat për sasi të nevojshme:

Tabela Nr.7

Nr.	Parametrat	Njësia e matjes	Specifikat
1	Gjendja	-	Lëng
2	Pamja	-	Pa ngjyrë e kthjellët transparente
3	Përçueshmëria elektrike	GOST- 5µS / cm	2,0-2,2 µS / cm
	Sasia		20 litra

8. Furnizimi me Acid Klorhidrik (HCl): tek tabela Nr.8 po japim specifikimet dhe të dhënat për sasi të nevojshme:

Tabela nr. 8

Nr	Parametrat	Njësia e matjes	Specifikimet
1	Gjendja	-	Leng i kthjellët
2	Ngjyra	-	E verdhe e lehte
3	Densiteti (20°C)	gr / ml	1.135–1.185
4	Titulli HCl	% (m/m)	30-33
5	Papastërti dhe sub. toksike	mg / kg	Limitet në mg/kg të HCl 100% (m/m)
6	Perberje organike të halogjenuara (si Cl)	mg / kg	max 17
7	Hekur (Fe)	mg / kg	max 170
8	Arsenik (As)	mg / kg	max 3
9	Kadmium (Cd)	mg / kg	max 1
10	Krom (Cr)	mg / kg	max 3
11	Merkur (Hg)	mg / kg	max 0.5
12	Nikel (Ni)	mg / kg	max 3
13	Plumb (Pb)	mg / kg	max 3
14	Antimon (Sb)	mg / kg	max 1
15	Selen (Se)	mg / kg	max 5
	Sasia	100 kg	

9.-Për furnizim me bufera për kalibrim:

- buffer solucion Ph 4.01 2 litra
- buffer solucion Ph 7.01 2 litra

Afati i skadimit duke filluar nga viti aktual të jetë 2(dy) vjet.

Kërkojmë furnizimin me material solucione pastrimi sipas përshkrimeve të mësipërme.

NJËSIA E PROKURIMIT

Roald Neziri

Rudina Bregu

Frederik Hamzallari
